REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorezuar Primljeno/Predato Recieved/Delivery | 15 . 10 . 2018 | | vit god year |
|---|---|---|---|
| Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No: | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPMSHCK | 6003/2018 | | 1/2 |

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

**A nr.608/2018**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Hajzer Salihu kryetar, Eshref Shabani dhe Shkëmb Manaj-anëtar, me Sabile Avdyli-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 5574/2018 të datës 28.09.2018 të parashtruar nga ankuesi Shpëtim Gashi, me banim në rr. "Wesly Clark" në Pejë, kundër autoritetit punëdhënës-Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.10.2018, mori këtë:

### V E N D I M

**Shpallet jo kompetent** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur lidhur me ankesën me numër protokolli 5574/2018 të datës 28.09.2018, të parashtruar nga ankuesi Shpëtim Gashi.

### A r s y e t i m

Ankuesi, Shpëtim Gashi aplikues në konkursin e shpallur me datën 23.06.2018 për pozitën "Auditor i Rregullsisë" me numër të referencës ARR/ZKA/09-06/18 në Zyrën Kombëtare të Auditimit. I pakënaqur me njoftimin e datës 01.08.2018 për kandidatët e suksesshëm, me datën 11.08.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Zyrën Kombëtare të Auditimit me datën 30.08.2018 nxjerr Vendimin me nr. 1611ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër 1611 të datës 30.08.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me datën 28.09.2018 parashtron ankesë me numër protokolli 5574/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 5574/2018 të datës 28.09.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr.07/2018 të datës 30.08.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Zyrën Kombëtare të Auditimit; Korrigjimi i Vendimit nr.07-1/2018 i datës 04.09.2018; Kopja e konkursit; Njoftim i listës të kandidatëve të



REPUBLIKA E KOSOVËS - KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

përzgjedhur për testin me shkrim i datës 17.07.2018; Rezultatet e testit me shkrim i datës 23.07.2018; Njoftimi për kandidatët e suksesshëm i datës 01.08.2018; Diploma e Fakultetit Ekonomik e datës 29.12.2016 me të cilën dëshmohet se kandidati Shpëtim Gashi ka mbaruar studimet me 21.03.2008 dhe mori titullin bachelor për banka, financa dhe kontabilitet.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështje, sepse ankuesi Shpëtim Gashi në ankesën e parashtruar më datë 28.09.2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka kontestuar procedurën e rekrutimit për pozitën "Auditor i Rregullsisë" të shpallur nga Zyra Kombëtare e Auditimit, e cila pozitë nuk hyn në kategorinë e pozitave të nëpunësve civil, sepse "auditorët" në Zyrën Kombëtare të Auditimit, nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, respektivisht janë përjashtuar nga kjo kategori me nenin 15 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: ***"Legjislacioni përkatës për shërbimin civil, nuk zbatohet vetëm për Auditorin e Përgjithshëm, zëvendës auditorin e përgjithshëm, ndihmës auditorët e Përgjithshëm dhe auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa stafi tjetër trajtohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil".***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas shqyrtimit të lëndës, dhe bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike**: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Vendimi i dërgohet**:
- Ankuesit Shpëtim Gashi;
- Auditorit të Përgjithshëm në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**
**Lënda me numër A nr.608/2018;**

**Hajzer Salihu**
**Kryetar i Kolegjit**

**Sabile Avdyli**
**Procesmbajtëse**